

# DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

## ZYRA E SUPERINTENDENTIT

440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301

PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

WILLIAM R. HITE, JR., Ed.D.  
SUPERINTENDEN

TELEFON (215) 400-4100  
FAKS (215) 400-4104

Të dashur Prindër/Kujdestarë,

Për javë me rradhë, personeli i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, ka punuar me përkushtim, për përgatitjen e ditës së parë të shkollës të vitit mësimor 2013-2014, ditën e Hënë datë 9 Shtator. E megjithë atë, akoma ka mjaft paqartësi për rritjen e fondeve dhe kursimet që duhen bërë, për të siguruar burime shtesë për shkollat tona.

Deri më tani nuk ka rezultate të qarta për rritjen e fondeve, që do t'a lejonin Drejtorinë Arsimore të rimarrë në punë shumë prej personelit të domosdoshëm, të cilët e ndërprejnë punën në Qershor. Ne e kemi të nevojshme punën e këtij personeli për të garantuar që shkollat tona të vazhdojnë sa më mirë punën e tyre, dhe mbi të gjitha sigurinë e tyre. Ndërsa Drejtoria së fundmi ka plotësuar disa prej pozicioneve të personelit, aktiviteteve jashtë shkollore dhe programeve të artit dhe muzikës, ne nuk e kemi mbështetjen, personelin dhe burimet që t'i ofrojmë të gjitha shkollave mjetet e tyre të nevojshme.

Javëve të fundit, ne kemi pritur marrjen e një fondi prej \$50 milion nga qyteti. Nëse Drejtoria nuk i merr këto fonde deri ditën e Premte, 16 Gusht, atëhere ne do të jemi të detyruar të marrim në konsideratë shtyrjen e ditës së parë të shkollës, në disa shkolla ose në të gjitha, ose të punojmë me gjisëm dite shkollore.

Unë duhet të jem në gjendje t'ju them se kur fëmija juaj ecën në korridor, ha drekën ose është në pushim, një i rritur kujdeset për ta. Unë duhet të jem në gjendje t'ju them se një ndihmës i drejtorit do të jetë aty, që të merret me problemet e disiplinës që prishin mësimin. Unë duhet të jem në gjendje t'ju them se drejtori mund të largohet nga zyra dhe të merret me personelin, në pjesët e tjera të shkollës. Në mungesë të fondeve shtesë, unë nuk mund të veproj kështu.

Në një pamje më të plotë, megjithatë, \$50 milion, realisht na lejon ne të hapim dyert e shkollës. Kjo shumë nuk mjafton për atë që kryhet brenda këtyre dyerve. Ne duhet të vazhdojmë të punojmë me partnerët tanë dhe zyrtarët e shtetit për sigurimin e fondeve shtesë. Kjo do të na lejojë evitimin e alternimit të klasave, vazhdimin e mbështetjes mësimore për nxënësit e prapambetur, futjen e gjuhëve të tjera që përgatitin nxënësit për ekonominë globale, aktivitetet jashtëshkollore për pasurimin e përvojës së nxënësve, ofrimin e klasave të avancuara për rritjen e njohurive dhe aftësive dhe shërbimet këshilluese në përgatitjen për në kolegji.

Unë ju inkurajoj në përgatitjen e fëmijës tuaj për vitin e ardhshëm shkollor me listën e librave të leximit gjatë verës (të postuara në websajtin e Drejtorisë) dhe aktivitetet e pasura. Regjistrimi për nxënësit e rinj imigrantë është në vazhdim dhe regjistrimi i përgjithshëm në shkollat e lagjes do të fillojë ditën e Hënë, 19 Gusht.

Ne ju kërkojmë ndjesë për këto rrethana të pafavorshme dhe shpresojmë të arrijmë një zgjidhje të shpejtë, për këtë çështje urgjente. Ju lutemi bëhuni me dije, se ne e presim me padurim ardhjen e fëmijës tuaj përsëri në shkollë, këtë Shtator.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.  
Superintendent